

Einverständniserklärung zur Abgabe von Kaliumjodidtabletten in Kinderbildungs- und -betreuungseinrichtungen

Deklaratë Pëlqimi për dhënien e tabletave të Kaliumjodidit në Institucionet për Përkujdesje dhe Arsimim të Fëmijëve

Të dashur Prindër dhe Kujdestarë Ligjorë!

Pajisja me tableta Kaliumjodidi është një masë e rëndësishme preventive për të mbrojtur fëmijën tuaj nga kanceri i gjëndrrës tiroide, në rast të ndonjë aksidenti të rëndë në centralet bërthamore.

Këto tableta mund t'i merrni falas për fëmijën/fëmijët tuaj në barnatore ose te mjeku juaj familjar, për rezerva shtëpiake. Në këtë mënyrë, ju mund ta mbronni fëmijën tuaj efektivisht nëse autoritetet shëndetësore japin urdhër për marrjen/pirjen e tabletave në rast të ndonjë katastrofe bërthamore.

Poqese, në rast të një fatkeqësie bërthamore, alarmimi jepet gjatë kohës kur fëmija është duke qëndruar në kopsht, strehë ditore (Hort) ose në internat (Kinderheim), fëmija juaj mund të marrë dozën e parë ditore në atë vend. Këto institucione i mbajnë tabletat e nevojshme të gatshme për fëmijën tuaj, në çdo kohë.

Në rast katastrofe fëmijëve u jepen tabletat sipas udhëzimeve strikte të Institucioneve Shëndetësore si dhe në pajtim me Deklaratën tuaj paraprake të Pëlqimit. Nëse keni nënshkruar Deklaratën e Pëlqimit, fëmijës tuaj mund t'i jepet doza e parë e tabletave të Kaliumjodidit qysh në kopsht, në strehë ditore ose në internat. Në internat dhënia e tabletave mund të vazhdojë për disa ditë me radhë, nëse Institucionet Shëndetësore urdhërojnë një gjë të tillë. Miratimi juaj vlen për tërë kohëzgjatjen e vijimit të këtyre institucioneve.

Ju lutemi që para dhënies së pëlqimit, të lexoni me kujdes fletudhëzimin e bashkëngjitur!

Me respekt

Personeli udhëheqës

E I N V E R S T Ä N D N I S E R K L Ä R U N G Z U R A B G A B E V O N K A L I U M J O D I D T A B L E T T E N I N K I N D E R B I L D U N G S - U N D - B E T R E U U N G E I N R I C H T U N G E N

D E K L A R A T Ë P Ë L Q I M I P Ë R D H Ë N I E N E T A B L E T A V E T Ë K A L I U M J O D I D I T N Ë I N S T I T U C I O N E T P Ë R P Ë R K U J D E S J E D H E A R S I M I M T Ë F Ë M I J Ë V Ë

Emri i fëmijës

Data e lindjes

Emri i/e kujdestarit/es ligjor/e (Prindit)

Atë që vlen, shënojeni me kryq

PO, në përputhje me fletëudhëzuesin e bashkëngjitur për prindër dhe kujdestarë ligjorë, jap pëlqimin tim, që fëmijës sim, në rast të ndonjë katastrofe – pas udhëzimit të autoriteteve shëndetësore – t'i jepen tabletat e Kaliumjodidit dhe konfirmoj se nuk kam njohuri lidhur me mbindjeshmëri, gjegjësisht kontraindikacione të fëmija im, në rast të marrjes së tabletave të Kaliumjodidit.

JO, nuk e jap pëlqimin tim.

.....
Data

.....
Nënshkrimi i
kujdestarit/es ligjore

Merkblatt für Eltern und Erziehungsberechtigte Fletëudhëzues për Prindërit dhe Kujdestarët ligjorë

Dhënia e tabletave të Kaliumjodidit pas fatkeqësive bërthamore

Përse duhet të merren tabletat e Kaliumjodidit?

Sipas njohurive të deritashme, katastrofa bërthamore e Çernobilit ka shkaktuar rritje drastike të kancerit të gjëndrrës tiroide tek fëmijët në Bjellorusi, në Ukrainë dhe në disa pjesë të Rusisë. Në rajonet më të ngarkuara, ky lloj kanceri është konstatuar në një shkallë shumëfish më të lartë se sa përqindja e zakonshme.

Pas fatkeqësive bërthamore, Jodi radioaktiv mund të lirohet në masë të madhe, dhe, nga Reaktorët pranëkufitarë në rast të kushteve të pavolitshme klimatike, mund të bartet edhe tek ne. Nëse merren me kohë, tabletat e Kaliumjodidit ofrojnë një mbrojtje efektive ndaj absorbimit të jodit në gjëndrrën tiroide dhe, në këtë mënyrë, edhe ndaj kancerit të gjëndrrës tiroide. Prandaj, pajisja me këto tableta paraqet një masë shumë të rëndësishme mbrojtëse nga rrezatimi.

Për mbrojtje nga substancat tjera radioaktive si dhe nga rrezatimi i jashëm, aplikohen masa të tjera mbrojtëse nga rrezatimi.

Kur duhet të merren tabletat e Kaliumjodidit?

NË RAST TË NDONJË KATASTROFE TABLETAT E KALIUMJODIDIT GUXOJNË TË MERREN, GJEGJËSISHT TË JEPEN, VETËM PAS URDHËRIT TË QARTË TË AUTORITETEVE SHËNDETËSORE.

Një urdhër i tillë publik mund të pritët vetëm atëherë kur:

- në zonë pranëkufitare ndodh një fatkeqësi e rëndë bërthamore gjatë së cilës lirohet sasi tejet e madhe e jodit radioaktiv **dhe**
- për shkak të kushteve atmosferike llogaritet të ketë bartje masive të jodit radioaktiv për në Austri.

Urdhëresa mund të jepet edhe gjatë kohës kur fëmija juaj është duke qëndruar në kopsht, në strehë ditore ose në internat.

Në këtë rast, dhënia e shpejtë e dozës së parë ditore në kopsht, në strehë ditore ose në internat është shumë e rëndësishme për mbrojtjen e fëmijës suaj. Për këtë arsye, në këto

vende mbahet e gatshme doza e parë ditore e Kaliumjodidit për fëmijën tuaj. Për fëmijët në Internate mbahet nga një pako e plotë prej 10 tabletash.

Për t' i dhënë fëmijës suaj tabletat e Kaliumjodidit në kopsht, në strehë ditore apo në internat, është i domosdoshëm pëlqimi juaj.

Në rast të ndonjë katastrofe parashikohet kjo rrjedhë:

- NË RAST AFRIMI TË RREZIKUT SINJALIZIM PËRMES SIRENËS OSE MAKINAVE ME ALTOPARLANTE
- TË KYÇET RADIO/TV
- VETËM PAS URDHËRIT TË QARTË NGA ANA E INSTITUCIONEVE T' U JEPEN TABLETAT E KALIUMJODIDIT FËMIJËVE, PRINDËRIT E TË CILËVE KANË DHËNË PËLQIMIN PARAPRAK
- TË PRITEN, GJEGJËSISHT, TË NDIQEN UDHËZIMET VIJUESE TË INSTITUCIONEVE

Kush duhet të marrë tabletat e Kaliumjodidit?

Përvojat nga Çernobili dhe njohuritë e deritanishme shkencore kanë vërtetuar se fëmijët dhe të rinjtë janë posaçërisht të rrezikuar të sëmuren nga kanceri i gjëndrrës tiroide në rast të lirimit masiv të jodit radioaktiv.

Prandaj, aksioni i pajisjes publike i dedikohet posaçërisht grupmoshave të fëmijëve dhe të të rinjve.

Si merren/dozohen tabletat (Doza ditore)?

Tabletat, gjegjësisht, copat e tabletës shtypen dhe merren/pihen me lëng, ose, eventualisht me pak ushqim. 1 Tabletë përmban 65 mg Kaliumjodid; sipas nevojës tabletat mund të ndahen në gjysma ose në çerekë.

Dozimi

| | |
|--|----------------------|
| Të porsalindurit (Muaji i parë i jetës) | njëherë ¼ e tabletës |
| Fëmijët e vegjël (nga fillimi i muajit të 2. të jetës deri nën 3 vjeç) | ½ e tabletës në ditë |
| Fëmijët nga 3 deri nën 12 vjeç | 1 tabletë në ditë |
| Të rinjtë nga 12 deri nën 18 vjeç | 2 tableta në ditë |
| Shtatzënat dhe gratë që japin gji | njëherë 2 tableta |
| Personat nga 18 deri nën 40 vjeç | njëherë 2 tableta |

Kundërindikacionet

Në rast dyshimi pyetni mjeken/mjekun tuaj!

Tabletat e Kaliumjodidit 65mg nuk guxojnë të merren në rast se:

- Keni njohuri për mbindjeshmëri ndaj jodit, si p.sh. Jododerma tuberosum (ndryshime në lëkurë në trajtë të shpuzës së butë, në ngjyrë të kuqe të mbyllët e në formë të ënjtur me sipërfaqe të rreshkur)
- Keni njohuri lidhur me mbindjeshmëri ndaj ndonjë përbërësi të preparatit
- Keni pasur sëmundje të mëhershme ose keni sëmundje aktuale të gjëndrrës tiroide (si p.sh. funksion i rritur i gjëndrrës tiroide)
- Dermatitis herpetiformis (sëmundje kronike e rikthyeshme e lëkurës që manifestohet me flluska të ngjashme me ato të herpesit, me ekzeme dhe me kruarje që djeg

Sprache: Albanisch

- Vaskulitisi Hipokomplementar (ndezje e mureve të enëve të gjakut e shkaktuar nga alergjia)

Ju lutemi t'i tregoni personelit udhëheqës të kopshtit, të strehës ditore ose të internatit menjëherë çdo ndryshim lidhur me kontraindikacionet.

Masa paralajërimit

Kujdes i veçantë duhet kushtuar personave me

- Astmë bronkiale
- Insuficiencë/Pamjaftueshmëri të zemrës
- Çrregullime të funksionit të veshkëve
- Sëmundje autoimune.

Në këto raste lutemi të pyesni mjeken/mjekun tuaj, nëse fëmija juaj bën të përdorë Kaliumjodidin. Në këtë rast mjekja/mjeku juaj do të bëjë ose do të udhëzojë kontrollat e domosdoshme dhe do të sqarojë me ju mundësinë e marrjes së këtyre tabletave. Në këto raste kini parasysh edhe nevojën e vizitave kontrolluese të fëmijës suaj pas marrjes së tabletave ashtu siç do të konsultoheni me mjeken/mjekun tuaj.

Efektet anësore

Nëse tabletat e Kaliumjodidit merren në lukth të zbrazët, atëherë mund të pasojë një iritim i lehtë i mukozës së lukthit menjëherë pas marrjes së tabletës. Prandaj tabletat duhet të treten në ndonjë lëng dhe eventualisht, të merren krahas një ushqimi të vogël.

Disa orë pas pirjes së tabletave Kaliumjodid mund të paraqiten para së gjithash reaksione mbindjeshmërie: Skuqje lëkure, skuqje kalimtare e fytyrës, përkeqësim i sëmundjeve ekzistuese të lëkurës, akne, ndezje të mishit të dhëmbëve, të koniunktivit ose ndezje të mukozës së hundës, rritje e sekrecionit mukoz (këlbasës) në bronke.

Kaliumjodidi mund të shkaktojë sëmundje të gjëndrrës tiroide. Nëse disa ditë deri disa javë pas marrjes së tabletave të Kaliumjodidit te fëmija juaj shfaqen pulsi i shpejtuar ose valë djersitjesh ju lutemi të kontakoni mjeken/mjekun tuaj.

Pas katastrofës bërthamore në Çernobil, preparatet e jodit i janë shpërndarë më shumë se 10 mil. fëmijëve dhe më shumë se 6 mil. të rriturve në Poloni. Efektet e vërejtura anësore në këto raste kanë qenë të buta dhe kaluese.

Në çdo rast dyshimi ju lutemi konsultoni mjeken/mjekun tuaj. Nëqoftëse te fëmija juaj konstatohet ndonjëra nga sëmundjet ose vështirësitë e lartpërmendura, ju lutemi të lajmëroni sa më parë personelin udhëheqës të kopshtit, të strehës ditore ose të internatit.

Në rast të paraqitjes së efekteve anësore duhet kërkuar këshilla mjekësore.